Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**09.01.2024**	**12.01.2024**	**2024/0006**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.01.2024, OE "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0006, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i rrjetit te kanalizimeve fekale dhe atmosferike" me nr. të prokurimit: "615-23-4020-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës Lot 1: 2,784,048.13€€..

Ankesë e përsëritur lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0531 i dt:21.11.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Hapja e Ofertave 13.06.2023.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 14.07.2023.

Kërkesa për rishqyrtim 19.07.2023.

Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim 21.07.2023.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 14.12.2024.

Kërkesa për rishqyrtim 19.12.2023.

Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim 22.12.2023.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe Argumentet

1. **AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së** pasi që gjatë procesit të vlerësimit të dhe administrimit me procedurën e prokurimit në fjalë nuk ka luajtur aspak rol akt siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe ekonom ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkes kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më s AK pa asnjë të drejtë ligjore na ka eliminuar si të papërgjegjshëm edhe pse ne plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. E gjithë kjo ka ndikuar negati shfrytëzimin e parasë publike sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse në vend që nënshkruhet kontrata e të vazhdohet me realizimin e projektit, AK e anulon tenderi prolonguar realizimin e projektit pa asnjë bazë ligjore. Krejt këto kanë ndikuar që ve AK-së të cilësohen me të drejtë si veprime që bien në kundërshtim të plotë me nenin të LPP-së.

2. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderit tonë ka kritere që nuk i ka pasur fare të përcaktuara tek kërkesat e parashtruara në dosjen e Këtë veprim të AK-së e ndalon rreptësishtë paragrafi 3 i këtij neni i cili shumë qartë se:

> Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të k dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përja nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i c njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Kërkesa e aplikuar si kërkesë shtesë nga komisioni gjatë procesit të ri-vlerësimit e ishte përcaktuar fare në dosje të tenderit është ajo që thotë se pajisjet për shpime ho nuk janë në përputhje me kërkesën e tenderit sepse nuk e plotësojnë kushtin kinse pë deri në 500mm. Ja si duket kërkesa e dosjes së tenderit për këto pajisje:

	11 ton		
22	Makinë për shpime horizontale	2	

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Pra po shihet se tek kërkesa për pajisjen për shpime horizontale nuk ka pas asnjë p detal që të i referohet ndonjë dimensioni të caktuar të pajisjes.
Pavarësisht kësaj ne për këtë qëllim kemi dorëzuar tre pajisje të cilat janë mjaftues realizimin e shpimeve të tilla (*shih dëshmitë e marrjes e qira nga MVR Elektromon nga Xhema Com*) andaj kriteri i aplikuar nga AK nuk ishte i përcaktuar fillimisht në tenderit dhe veprimi i tillë është plotësisht në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve n përmbajtur dispozitave të këtij nenin. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse
në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njo
kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kon
mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gab
paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo a
tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të sh
ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e
parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që,
devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasy
vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Para se ta elaborojmë secilën pikë të eliminimit duke i argumentuar me fakte mbështetje ligjore në bazë të të cilave edhe do të konstatohet se AK ka

kundërligjshëm, po i paraqesim vizualisht arsyet pse AK na ka cilësuar papërgjegjshëm:

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Eshte kerkuar nje Lead Auditor i licencuar diploma e te cili eshte kerkuar te jete e noterizuar dhe noterizimi te mos jete me I vjeter se 30 dite nga data e njoftimit per kontrate, ju keni nje noterizim me date 29.07.2020
2. Tek Aneksi 7 – eshte kerkuar kamion kipper me kran me peshë bartëse min 11 ton, ju keni ofruar nje kamion me vinq por jo edhe kipper
   Jane kerkuar 2 cope makine per shpime horizontale, ju keni ofruar nje marreveshje me NSH MVR Elektromontues per nje pajisje e cila përdoret për shpime horizontale per shtrirje te rrjetit te kabllimit me diameter te vogel ndersa projekti ne fjale k ate beje me diameter te medhenje minimum OD 500mm.
3. Mungon kontrata ne KMDK, ju keni prezantuar nje kontrate me kompanine Pastrimi ku object I kontrates eshte zbrazja e mbeturinave nga kontenjeri 7.1m3 gje qe nuk k ate beje me kerkesen e AK ne DT.
4. Vendimi per caktimin e menaxherit, udheheqesit dhe gjeodetit eshte nxjerr me date 13.02.2022, qe do te thote para dates se Njoftimit per Kontrate

Nga kjo shihet se konstatimi i AK-së përpos që bie ndesh me realitetin që mbre tenderin tonë, ai është kundërshtim edhe me vet vendimin paraprak të AK-së me të jemi cilësuar si të përgjegjshëm. Gjithashtu edhe vendimi i OSHP-së ka qenë për ri- të tenderit që AK e ka shpallur fitues e jo për rivlerësim të të gjithë tenderuesve. I gjatë vlerësimit në herën e parë jemi cilësuar si të përgjegjshëm dhe se ask konkurrentët nuk e ka kontestuar një vlerësim të tillë, nënkupton se vlerësimi tenderit tonë është kryer një herë dhe sipas praktikave të prokurimit AK nuk është d të merret me tenderin tonë. Po të ishte e nevojshme një gjë e tillë, sigurisht që OSHP-së do të ja jepte një rekomandim për këtë qëllim.

Tani po i argumentojmë pretendimet tona lidhur me arsyet e paligjshme të cil tenderit tonë si të papërgjegjshëm.

Arsyeja e parë - Bazuar në nenin 59.4 dhe në nenin 72 të LPP-së si dhe duke respel here nenin 1 të LPP-së, me që AK i ka hyrë prapë vlerësimit të tenderit tonë, është c të kërkoj sqarime lidhur me diplomën e LEAD AUDITOR-it pasi që sipas ligjit kon se është dokument objektivisht i verifikueshëm. Edhe neni 59.4 i LPP-së pjesa *nënvizuar*), shumë qartë e thotë se gabimet të cilat nuk ndikojnë në ndryshime substa dhe nuk krijojnë ndryshime materiale apo devijime në karakteristikat e tenderit, konsiderohen devijime minore dhe të pranohen si të tilla. Diploma e LEAD AUI nuk e ndryshon vlerën dhe nuk e bënë më pak profesional personin e tillë vetëm për është e noterizuar më herët se 30 ditë para hapjes publike. Vlerën e diplomës së ti ndryshon noterizimi i saj. Dihet qartë se **Noterizimi** kërkohet me të vetmin qëllim kursej kohën AK-së për verifikim të vërtetësisë së dokumentit të tillë. Vërtetësinë e e ka konfirmuar Noteri një herë dhe tani ajo nuk e ndryshon apo e as nuk e humbë saj vetëm pse ky noterizim është bërë më herët se 30 ditë nga data e tenderimit. Përp kjo diplomë do duhej konsiderohej e pranueshme edhe për faktin që sipas LPI kërkesë lidhur me përshtatshmërinë profesionale e parashtruar kundrejt OE du paraprijë periudhës kohore para njoftimit për kontratë. Diploma e tillë është e fituar date andaj si e tillë edhe nëse nuk do të dorëzohej fare, AK ligjërisht do ta kishte o

kërkonte. Bazuar në krejt këtë sqarim dhe në atë që e thotë neni 59.4 dhe 72 i LF
dokument e plotëson kushtin që të konsiderohet i pranueshëm si dhe e plotëson kusl
për tu sqaruar/verifikuar nga ana e AK-së nëse ka ndonjë dyshim ndaj tijë.

Arsyeja e dytë - Tek ky arsyetim AK nuk ka vepruar aspak sipas dispozitave ligjo
me vlerësimin sqarimin dhe krahasimin e tenderit tonë pasi që Kamioni i paraqitur
cilin AK e konteston, është plotësisht sipas kërkesave të AK-së gjë të cilën e dë
fotografitë dhe dëshmitë tjera të dorëzuara për të. Ngjashëm e plotësojnë kërkesën e
tenderit edhe pajisjet për shpime horizontale të cilat janë saktë ashtu siç edhe janë
nga AK përmes dosjes së tenderit. Për çështjen e kamionit AK është dashur të kërko
shtesë dhe ne do ta bindnim AK-në se kamioni i tillë është kamion me vinç dhe g
edhe kiper. Këtë po ua dëshmojmë edhe përmes fotografive që do të i paraqesim në
nga ku shihet hapur se kjo pajisje e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Pavarësisl
në librezë nuk i shkruan se është me kiper, kjo nuk do të thotë se nuk e posedon kip
AK duhet ta ketë parasyshë që jo çdo here libreza e regjistrimit i përshkruan
karakteristikat teknike dhe funksionet e pajisjeve. Përpos kësaj askund në dosjen e
nuk ka qenë e përcaktuar që në librezën e regjistrimit të pajisjeve të ceken
funksionet e pajisjes. Është përgjegjësi dhe kompetencë ekskluzive e qendrës së re
të automjeteve të vendosin se çfarë informatash lidhur me llojin dhe funksionin e pa
vendosen në librezën e regjistrimit. Ja dëshmia:

Edhe për sa i përket pretendimit lidhur me pajisjet për shpime horizontale, atë elaboruar tek pika 2 si pretendim për shkeljen e nenit 56 të LPP-së nga ku shihet se ı plotësuar këtë kërkesë saktë ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Me që AK përcaktuar dimensionin e pajisjes, nuk ka të drejtë në asnjë formë që ta aplikoj si kri gjatë vlerësimit të tenderëve. Lidhur me këto dhe lidhur me komplet tenderin tonë A duhej të merrej më sepse plotësueshmëria e tyre është vërtetuar një here nga vet ko tyre i cili i ka pranuar si të rregullta dhe si kritere të plotësuara.

Arsyeja e tretë - Lidhur me kërkesën që OE duhet të kenë kontratë me KMD hedhjen e mbeturinave që dalin nga realizimi i këtij projekti, ne kemi paraqitur një me KRM "Pastrimi" e cila sipas kësaj kontrate do të instaloj kontejner me volum 7 hedhjen e mbeturinave të tilla që dalin gjatë realizimit të punimeve në këtë projek kemi bërë me të vetmin qëllim që puna të realizohet më shpejt dhe që ne të mos ker për dërgimin e mbeturinave të tilla deri tek deponia e KMDK-së por ato do të hidh në kontejnerët e tillë që mandej KRM Pastrimi do i zbrazte duke i dërguar në de KMDK-së sipas kontratës që ata e posedojnë për këtë qëllim. Kjo është plotësisl sidomos duke u mbështetur në nenin 69.8 të LPP-së i cili qartë e thotë se:

Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të ve mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën l lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontra ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, ...

Pra bazuar në këtë dhe bazuar në raportet që KRM Pastrimi ka me KMDK-në, ko
fjalë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit që ishte vendosur vetëm për qëllimin e
që mbeturinat do të hedhen në deponitë adekuate e jo nëpër deponi të egra apo në
ndryshme publike e private me çka edhe do të ndotej ambienti. Kjo ofron siguri ed
lartë për atë qëllim dhe realisht si marrëveshje është edhe më e favorshme sido
menaxhimin e mbeturinave të tilla sepse mënyra e tillë është shumë më efikase
dërgonim ne vet mbeturinat tek depo e KMDK-së pasi që kështu bëhet dhe ruajtja e p
së rrugëve të cilat zakonisht i ndotin kamionët që dalin nga vend punishtet për l
mbeturinave.

Arsyeja e katërt – Bazuar në vendimet e dorëzuara nga ne për caktimin e men kontratës dhe udhëheqësin e punishtes shihet se ato i plotësojnë të gjitha kushtet d ligjore për tu cilësuar si të rregullta. Fillimisht munden të trajtohen sipas nenit 59.4 ku gabimi në datën e vendimit konsiderohet plotësisht gabim teknik i cili nuk ndi në devijimin substancial të tenderit tonë. Pavarësisht kësaj dhe duke u bazua dispozitën ligjore e cila e thotë qartë se të gjitha kërkesat lidhur me aftësinë te profesionale të OE duhet të i paraprijnë situatës para datës së njoftimit për kontra dokument i dorëzuar duhet të posedoj datën e para hapjes publike duke **mos e askund sa gjatë para hapjes publike**, vendimet e tilla duhet konsideruar ligjë pranueshme. Pra nuk ka asnjë dispozitë ligjore që ndodhet në legjislacionin pr sekondar të prokurimit që i jep të drejtë AK-së për të i cilësuar vendimet e til rregullta apo të pa pranueshme. Ligji dhe kërkesa e AK-së e kërkon që të jetë vend mos jetë i futur në dosje pas hapes publike, përndryshe nëse data është para hapj apo edhe nëse i mungon fare, vendimin e tillë nuk e zhvleftëson ky fakt sidomo emrin e projektit dhe numrin e projektit që sipas të gjitha dispozitave ligjore kërkesës së dosjes së tenderit konsiderohet i pranueshëm. Nisur nga kjo konst vendimet e tilla janë plotësisht të pranueshme dhe arsyetimi i tillë i AK për refuzi është tërësisht i pa-bazuar.

Referuar përgjigjes së AK-së të dhënë gjatë refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, s gjitha arsyetimet janë të pa argumentuara në aspektin ligjorë që të len përshtypj vetëm tentim për prolongim të pakuptimët të procesit. Asnjë nga arsyetimet nu bazuar ligjërisht e as e mbështetur me ndonjë faktim por të gjitha janë hamend thirrje në konstatime arbitrare.

Pas gjithë këtyre që i sqaruam më lartë, shihet se AK së bashku me Komisionin e nuk kanë vlerësuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe nuk kanë vl sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe kjo tregon se AK ka shkelur plotësisht n LPP-së.

4. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së si pasoj e mos respektimit të nenit 59 të LP pasojë vlerësimin jo të drejtë të tenderëve konkurrues ku për pasojë të kësaj ka a tek një aplikim i gabuar i nenit 62 të LPP-së dhe anulim i gabuar procedurës së p Anulimi i tenderit edhe pse në mesin e tenderuesve e ka një tenderues të për konsiderohet shkelje e parimeve të mira të prokurimit publik dhe konsiderohe komplet i gabuar i nenit 62 të LPP-së. Në rastin e tillë si pasojë e anulimit të p tenderit po prolongohet projekti duke shkaktuar vonesa dhe shpenzime të par operative që është tregues real i mos shfrytëzimit të buxhetit në mënyrë efikase dh nga ana e AK-së

Nga krejt kjo po shihet hapur se veprimi i AK-së për anulim të tenderit përbën

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe
që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mos respektimi i dëshm
kualifikuese, mos respektimi i dëshmive për stafin profesional dhe mos resp
dëshmive për pajisjet e paraqitura janë tregues të mjaftueshëm për të konstatuar s
shkelur plotësisht nenin 69 të LPP-së. Këtë e vëreni nëse i shihni me kujdes dëshmit

paraqitura në tenderin tonë të cilat tregojnë të kundërtën e asaj që e thotë AK në r
mbi eliminim e tenderit tonë.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit të ri-vlerësimit sepse nuk ka
fare sqarime për disa paqartësi që shihet se i ka pasur tek tenderi jonë por pavarësis
ka vepruar në mënyrë arbitrare pa u siguruar me gjendjen reale duke na elimi
mangësi që do duhej sqaruar detyrimisht. Detyrimi i AK-së tregohet shumë qartë tek
i LPP-së si dhe tek neni 38 të RRPP-001/2022 ku përshkruhet detalisht se si duhet
për të sqaruar mangësitë, dhe paqartësitë në tenderët konkurrues. Në vazhdim po pa
vetëm atë që e kërkon neni 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomi
është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifik
autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojn
plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur bren
një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë r
parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të
qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për
dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e
tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra bazuar në këtë që e thotë ky nen, shihet hapur se AK është dashur të kërkoj sqa
të gjitha paqartësitë që i ka pasur rreth dëshmive tona ku pa asnjë të drejtë të një
cilësuar si të pa pranueshme duke na eliminuar dhe duke e shkelur plotësisht nen
LPP-së.

Nisur nga krejt kjo që sqaruam më lart mendojmë se i kemi elaboruar mjaftueshëm s
AK-se gjatë rivlerësimit të tenderit andaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyr
pretendimeve tona të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e **Grupi i OE "Pro & Co Group SH.P.K.; Al SHPK; 2A Group SH.P.K."** lidhur me tenderin "**Ndërtimi i rrjetit të kanalizimev dhe atmosferike – Lot 1"** i iniciuar nga **KOMUNA E PODUJEVËS.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KOMUNA E PODUJEVËS** për a tenderit dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dis LPP-së e që besojmë se më pas do duhej që **Fitues** të shpallej **Grupi i OE "Pr Group SH.P.K.; ARLINDI SHPK; 2A Group SH.P.K."**

KRITERET PËR VLERËSIM

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë), në vlere minimale prej për LOT I - 4,000,000.00 € për LOT II - 400,000.00 €	**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje, nëse kontrata është me kompani private të dëshmohet me transaksione bankare (dëshmi që është kryer pagesa). Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.**
Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Për LOT I- a) 1 (një) Menaxher i projektit - Inxhinier i diplomuar ose master i Hidroteknikës, minimumi 10 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1 (një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. b) 1 (Një) Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv)- minimumi 10 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes të ketë minimumi 1 (një) projekt të udhëhequr në lëmin e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. c) 1 (një) Inxhinier i diplomuar i hidroteknikës ose bachelor i çertifikuar për testim të tubacioneve sipas standardit EN805 W400 d) 1 (Një) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Bahcelor (i licencuar) me minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum 1 (një) projekt të realizuara në lëmin e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. e) 1 (Një) ekolog (master i ekologjisë) drejtimi mbrojtje e ambientit me së paku 5 vite përvojë pune . f) 1 (Një) Lead Auditor i certifikuar sipas ISO 9001 2015, dhe i certifikuar nga MPMS si ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë. Për LOT II- a) 1 (Një) Menaxher i projektit - Inxhinier i diplomuar ose master i Hidroteknikës minimumi 5 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1 (një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. b) 1 (Një) Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv) minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes minimum 1 (një) projekt të	**Lista e stafit profesional të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin , Profesionin, Eksperienca (vitet) dhe pozicioni në kompani e nënshkruar dhe vulosur nga OE. P?ër pikën a-f OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës (për pikat c (llot I dhe II) dhe f (llot I) edhe të certifikatave) të noterizuar nga origjinali (noterizimi mos të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë). Kontrata ose marrëveshja për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin , nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt atëherë duhet të jetë e noterizuar nga origjinali. Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësit të jetë vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët dhe i noterizuar . AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara.**

udhëhequr në lëmin e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. c) 1 (Një) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Bachelor (i licencuar) minimumi 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum 1 (një) projekt të realizuara në lëmin e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania d) 1 (Një) ekolog (master i ekologjisë) drejtimi mbrojtje e mjedisit me së paku 5 vite përvojë pune .	
Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka staf të mjaftueshëm teknik për realizmin e këtij projekti Për LOT I- min. 25 të punësuar të trajnuar nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë. Nga të cilët a) min 5 punëtor të trajnuar nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë si vozitës eskavatori ; b) min 3 punëtor të trajnuar nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë si vozitës dhe manipulues me kran ; c) min 2 punëtor të trajnuar nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë si montues të gypave të kanalizimit dhe ujësjellësit; Për LOT II- min. 10 të punësuar. Nga të cilët min 5 punëtor të trajnuar nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë.	Lista e stafit teknik të kompanisë e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet ti bashkëngjiten kontratat ose parakontratat e punës si dhe certifikatat e trajnimit nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë (për dy llot) AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara.
Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT	Dëshmia 5. Lista e paisjeve sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve . Deklaratat unike doganore (DUD) ,faturat apo dëshmi tjetër valide - Librezat e qarkullimit me validitet.
Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe certifikuar me ISO standard si në vijim (kërkohet për llot I) a)ISO 9001 2015 b) ISO 14001 2015 c) ISO 45001 2018 d) ISO 3834-2 2006	Kopjet e certifikatave me validitet dhe të akredituara.
Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë (kërkohet për dy llot)	Operatorët Ekonomik duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rrizkut për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga MPMS.
OE duhet të ketë kontratë me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (kërkohet për dy llot)	Kontrata e nënshkruar dhe vulosur në mes KMDK dhe OE (valide)

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Podujevës **anulon**[3] aktivitetin e prokurimit – **Asnjë ofertues i përgjegjs**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues kualifikohet si palë me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i PSH.nr.2023/0531, dt.21.11.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Pro & Co Group SH.P.K.**

Sqarim Hyrës,

AK – Komuna Podujevë ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike – Lot 1", me nr. te prokurimit 615-23-4020-5-1-1.

Me dt. 04.05.2023, AK ka publikuar Njoftim mbi Vendimin e AK-së me dt.14.07.2023 ku në këtë rast ka rekomanduar për kontratë OE "Bini"&"NB COMPANY"&"ABC"-Podujevë, ndërsa OE ankues "Pro & Co Group SH.P.K.; ARLINDI SH.P.K.; 2A Group SH.P.K.", është cilësuar i pa sukseshëm, dhe ky OE i pa kënaqur me vendimin e AK-së, ka parashtruar ankesë në OSHP, për këtë ankesë egziston edhe Vendimi i PSH nr. 531/23, dt. 21.11.2023, në bazë të këtij Vendimi i është aprovuar ankesa OE ankues dhe AP të kthehet në rivlerësim.

Me dt. 14.12.2023, AK ka rivlersuar AP dhe në të njejtën ditë ka publikuar Njoftim mbi Vendimin e AK-

më, me të cilin Anulon AP dhe në Letrën Standarde për Tenderues të eliminuar, OE ankues eleminohet me arsyetimin se:

1. Eshte kerkuar nje Lead Auditor i licencuar diploma e te cili eshte kerkuar te jete e noterizuar dhe noterizimi te mos jete me I vjeter se 30 dite nga data e njoftimit per kontrate, ju keni nje noterizim me date 29.07.2020
2. Tek Aneksi 7 – eshte kerkuar kamion kipper me kran me peshë bartëse min 11 ton, ju keni ofruar nje kamion me vinq por jo edhe kipper
   Jane kerkuar 2 cope makine per shpime horizontale, ju keni ofruar nje marreveshje me NSH MVR Elektromontues per nje pajisje e cila përdoret për shpime horizontale per shtrirje te rrjetit te kabllimit me diameter te vogel ndersa projekti ne fjale k ate beje me diameter te medhenje minimum OD 500mm.
3. Mungon kontrata ne KMDK, ju keni prezantuar nje kontrate me kompanine Pastrimi ku object I kontrates eshte zbrazja e mbeturinave nga kontenjeri 7.1m3 gje qe nuk k ate beje me kerkesen e AK ne DT.
4. Vendimi per caktimin e menaxherit, udheheqesit dhe gjeodetit eshte nxjerr me date 13.02.2022, qe do te thote para dates se Njoftimit per Kontrate

OE ankues i pa kënaqur me vendimin e AK-së, ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim në AK dhe i është refuzuar kërkesa për rishqyrtim dhe i njejti ka parashtruar ankesë në OSHP.

Pretendimin ankimor 1

Përmbledhje e Pretendimit Ankimor 1

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në fjalë nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa asnjë të drejtë ligjore na ka eliminuar si të papërgjegjshëm edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. E gjithë kjo ka ndikuar negativisht në shfrytëzimin e parasë publike sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse në vend që tani të nënshkruhet kontrata e të vazhdohet me realizimin e projektit, AK e anulon tenderin duke e prolonguar realizimin e projektit pa asnjë bazë ligjore. Krejt këto kanë ndikuar që veprimet e AK-së të cilësohen me të drejtë si veprime që bien në kundërshtim të plotë me nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Eksperti Shqyrtues sqaron se me rastin e rivlersimit te aktivitetit te prokurimit AK-ja, ka respektuar Nenin 1 dhe 6 te LPP-se per faktin se në këtë AP ka rezultuar që ansjë OE pjesmarrës nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ndërsa arsyetimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar për shkak se edhe OE anukes është i pa përgjegjshëm.

Pretendimin ankimor 2

Përmbledhje e Pretendimit Ankimor 2

2. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderit tonë ka aplikuar kritere që nuk i ka pasur fare të përcaktuara tek kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit. Këtë veprim të AK-së e ndalon rreptësishtë paragrafi 3 i këtij neni i cili shumë qartë e tregon se:

Kërkesa e aplikuar si kërkesë shtesë nga komisioni gjatë procesit të ri-vlerësimit e cila nuk ishte përcaktuar fare në dosje të tenderit është ajo që thotë se pajisjet për shpime horizontale nuk janë në përputhje me kërkesën e tenderit sepse nuk e plotësojnë kushtin kinse për shpime deri në 500mm. Ja si duket kërkesa e dosjes së tenderit për këto pajisje:

Pra po shihet se tek kërkesa për pajisjen për shpime horizontale nuk ka pas asnjë përcaktim detal që të i referohet ndonjë dimensioni të caktuar të pajisjes.

Pavarësisht kësaj ne për këtë qëllim kemi dorëzuar tre pajisje të cilat janë mjaftueshme për realizimin e shpimeve të tilla (*shih dëshmitë e marrjes e qira nga MVR Elektromontues dhe nga Xhema Com*) andaj kriteri i aplikuar nga AK nuk ishte i përcaktuar fillimisht në dosjen.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankues, per pajisjen Makinë për shpime horizontale 2 copë, e cila

kërkesë është paraparë në Aneksin 7 të DT-së. Eksperti Shqyrtues sqaron se OE ankues për plotësimin e makinerisë së theksuar ka Ofruar marrëveshje me OE N.N.SH "Xhema Com", ku kësaj marrëveshje i është ofruar edhe dëshmi DUD, emërtimi i pajisjes në këtë dokument është "Makinë e përdorur për shpim Horizontal".

Gjithashtu OE ankues ka ofruar edhe marrëveshje për shfrytëzimin e makinerisë me OE "N.SH.M.V.R Elektromontues", dhe është ofruar pajisja me emertimin "Shpuese e dheut,Horizontal me kompresim te ajrit. (me pjes percjellse) 1 set", per te cilen eshte ofruar edhe deshmi dokumentare.

Eksperti Shqyrtues e konsideron te bazuar pretendimin e OE ankues, per faktin se kerkesa e dosjes se tenderit eshte plotesuar me deshmit e ofruara nga OE ankues per ketë pajisje. Ndersa arsyetimi i dhene nga AK ne Letren standarde per tenderues te pa sukseshem eshte i pa qendrueshem, për faktin se AK ne kerkesen e saj nuk ka parapar ndonjë dimensionin/ diametrin e pajisjes per shpim horizontal se sa do te jete, Andaj aplikimi i nje kerkese te tillë bie ne kundershtim ne Nenin 56.3 të Rregullores per prokurim publik.

Pretendimin ankimor 3

Përmbledhje e Pretendimit Ankimor

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij nenin. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se:

Para se ta elaborojmë secilën pikë të eliminimit duke i argumentuar me fakte dhe me mbështetje ligjore në bazë të të cilave edhe do të konstatohet se AK ka vepruar

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Eshte kerkuar nje Lead Auditor i licencuar diploma e te cili eshte kerkuar te jete e noterizuar dhe noterizimi te mos jete me I vjeter se 30 dite nga data e njoftimit per kontrate, ju keni nje noterizim me date 29.07.2020
2. Tek Aneksi 7 – eshte kerkuar kamion kipper me kran me peshë bartëse min 11 ton, ju keni ofruar nje kamion me vinq por jo edhe kipper
   Jane kerkuar 2 cope makine per shpime horizontale, ju keni ofruar nje marreveshje me NSH MVR Elektromontues per nje pajisje e cila përdoret për shpime horizontale per shtrirje te rrjetit te kabllimit me diameter te vogel ndersa projekti ne fjale k ate beje me diameter te medhenje minimum OD 500mm.
3. Mungon kontrata ne KMDK, ju keni prezantuar nje kontrate me kompanine Pastrimi ku object I kontrates eshte zbrazja e mbeturinave nga kontenjeri 7.1m3 gje qe nuk k ate beje me kerkesen e AK ne DT.
4. Vendimi per caktimin e menaxherit, udheheqesit dhe gjeodetit eshte nxjerr me date 13.02.2022, qe do te thote para dates se Njoftimit per Kontrate

Nga kjo shihet se konstatimi i AK-së përpos që bie ndesh me realitetin që mbretëron në tenderin tonë, ai është kundërshtim edhe me vet vendimin paraprak të AK-së me të cilin ne jemi cilësuar si të përgjegjshëm. Gjithashtu edhe vendimi i OSHP-së ka qenë për ri-vlerësim të tenderit që AK e ka shpallur fitues e jo për rivlerësim të të gjithë tenderuesve. Me që ne gjatë vlerësimit në herën e parë jemi cilësuar si të përgjegjshëm dhe se askush nga konkurrentët nuk e ka kontestuar një vlerësim të tillë, nënkupton se vlerësimi real ndaj tenderit tonë është kryer një herë dhe sipas praktikave të prokurimit AK nuk është dashur më të merret me tenderin tonë. Po të ishte e nevojshme një gjë e tillë, sigurisht që vendimi i OSHP-së do të ja jepte një rekomandim për këtë qëllim.

Tani po i argumentojmë pretendimet tona lidhur me arsyet e paligjshme të cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Lidhur me këtë konstatim të OE ankues Eksperti Shqyrtues sqaron se: është i qëndrueshëm fakti se herën e parë OE ankues sipas letres standarde ka qenë i pa sukseshem, dhe në rivlersim të AP ka rezultuar i pa përgjegjshëm sipas AK-së. Vendimi i OSHP-së për rivlersim nuk ka nenkuptuar që në mënyrë automatike të shpallet fitues OE ankues mirëpo vendimi i OSHP ka obliguar AK që të rivlerësoj AP dhe kthimi i

lëndës në Rivlerësim e Obligon AK që pa modifikuar kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të bëjë rivlerësimin dhe të korrigjoj gabimet e veta. Kuptimin e Rivlerësimit të AP e pasqyron paragrafi 2 i nenit 40 të Rregullores për prokurim publik. Andaj në këtë pikë është i pa bazuar konstatimi i OE ankues.

OE ankues pretendon se:

Arsyeja e parë - Bazuar në nenin 59.4 dhe në nenin 72 të LPP-së si dhe duke respektuar çdo here nenin 1 të LPP-së, me që AK i ka hyrë prapë vlerësimit të tenderit tonë, është dashur që të kërkoj sqarime lidhur me diplomën e LEAD AUDITOR-it pasi që sipas ligjit konsiderohet se është dokument objektivisht i verifikueshëm. Edhe neni 59.4 i LPP-së pjesa e dytë(*e nënvizuar*), shumë qartë e thotë se gabimet të cilat nuk ndikojnë në ndryshime substanciale si dhe nuk krijojnë ndryshime materiale apo devijime në karakteristikat e tenderit, mund të konsiderohen devijime minore dhe të pranohen si të tilla. Diploma e LEAD AUDITOR-it nuk e ndryshon vlerën dhe nuk e bënë më pak profesional personin e tillë vetëm për faktin se është e noterizuar më herët se 30 ditë para hapjes publike. Vlerën e diplomës së tillë nuk e ndryshon noterizimi i saj. Dihet qartë se **Noterizimi** kërkohet me të vetmin qëllim që të ja kursej kohën AK-së për verifikim të vërtetësisë së dokumentit të tillë. Vërtetësinë e diplomës e ka konfirmuar Noteri një herë dhe tani ajo nuk e ndryshon apo e as nuk e humbë vlerën e saj vetëm pse ky noterizim është bërë më herët se 30 ditë nga data e tenderimit. Përpos kësaj, kjo diplomë do duhej konsiderohej e pranueshme edhe për faktin që sipas LPP-së, çdo kërkesë lidhur me përshtatshmërinë profesionale e parashtruar kundrejt OE duhet të i paraprijë periudhës kohore para njoftimit për kontratë. Diploma e tillë është e fituar para asaj date andaj si e tillë edhe nëse nuk do të dorëzohej fare, AK ligjërisht do ta kishte obligim ta kërkonte. Bazuar në krejt këtë sqarim dhe në atë që e thotë neni 59.4 dhe 72 i LPP-së, ky dokument e plotëson kushtin që të konsiderohet i pranueshëm si dhe e plotëson kushtin edhe për tu sqaruar/verifikuar nga ana e AK-së nëse ka ndonjë dyshim ndaj tijë.

Përgjigjje në arsyen e parë

Eksperti Shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "(Një) Lead Auditor i certifikuar sipas ISO 9001 2015, dhe i certifikuar nga MPMS si ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë".

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Për pikën a-f OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës (për pikat c (llot I dhe II) dhe f (llot I) edhe të certifikatave) të noterizuar nga origjinali (noterizimi mos të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë)".

Lidhur me plotësimin e Kërkesës së DT-së, OE ankues ka ofruar një Lead Auditor për të cilin si dëshmi dokumentare është bashkangjitur edhe *Certifikatë Trajnimi me temën LEAD AUDITOR për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit sipas Standardit Ndërkombëtar ISO*

14001:2015, dokument ky i cili është i noterizuar me dt. 29.07.2020. Andaj arsyetimi i OE ankues se dokumenti i lartepermendur është fituar para njoftimit për kontratë, nga këndëvështrimi i Ekspertit shqyrtus është i pa pranueshëm arsyetimi për faktin se ky dokument nuk është ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit, si dhe OE nëse ka pas dilema në lidhje me këtë kërkesë të DT-së, ka mundër të parashtroj ankesë në OSHP kundër njoftimit për kontratë, por kjo kërkesë e dosjes nuk është kontestuar nga asnjë OE pjesëmarrës në këtë AP,andaj sipas kerkeses së tillë OE nuk ka ofruar dëshminë konform kërkesës së dosjes së tenderit, Rrjedhimisht pretendimi ne arsyen e parë të eliminimit është i pa bazuar.

OE ankues pretendon se:

Arsyeja e dytë - Tek ky arsyetim AK nuk ka vepruar aspak sipas dispozitave ligjore lidhur me vlerësimin sqarimin dhe krahasimin e tenderit tonë pasi që Kamioni i paraqitur nga ne të cilin AK e konteston, është plotësisht sipas kërkesave të AK-së gjë të cilën e dëshmojnë fotografitë dhe dëshmitë tjera të dorëzuara për të. Ngjashëm e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit edhe pajisjet për shpime horizontale të cilat janë saktë ashtu siç edhe janë kërkuar nga AK përmes dosjes së tenderit. Për çështjen e kamionit AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë dhe ne do ta bindnim AK-në se kamioni i tillë është kamion me vinç dhe gjithashtu edhe kiper. Këtë po ua dëshmojmë edhe përmes fotografive që do të i paraqesim në vazhdim nga ku shihet hapur se kjo pajisje e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Pavarësisht asaj që në librezë nuk i shkruan se është me kiper, kjo nuk do të thotë se nuk e posedon kiperin dhe AK duhet ta ketë parasyshë që jo çdo here libreza e regjistrimit i përshkruan të gjitha karakteristikat teknike dhe funksionet e pajisjeve. Përpos kësaj askund në dosjen e tenderit nuk ka qenë e përcaktuar që në librezën e regjistrimit të pajisjeve të ceken të gjitha funksionet e pajisjes. Është përgjegjësi dhe kompetencë ekskluzive e qendrës së regjistrimit të automjeteve të vendosin se çfarë informatash lidhur

Edhe për sa i përket pretendimit lidhur me pajisjet për shpime horizontale, atë e kemi elaboruar tek pika 2 si pretendim për shkeljen e nenit 56 të LPP-së nga ku shihet se ne e kemi plotësuar këtë kërkesë saktë ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Me që AK nuk e ka përcaktuar dimensionin e pajisjes, nuk ka të drejtë në asnjë formë që ta aplikoj si kriter shtesë gjatë vlerësimit të tenderëve. Lidhur me këto dhe lidhur me komplet tenderin tonë AK nuk do duhej të merrej më sepse plotësueshmëria e tyre është vërtetuar një here nga vet komisioni i tyre i cili i ka pranuar si të rregullta dhe si kritere të plotësuara.

Përgjigjje në arsyen e dytë

Në dosje të tenderit tek Aneksi 7 është kërkuar Pajisja Kamion kiper me kran me peshe bartese min 11 Ton.

OE ankues për plotësimin e kërkesës së Aneksit 7 të DT-së, ka ofruar pajisjen me nr. te targave 06-316-FD. Në bazë të përshkrimit të dhënë në librezë emërtimi i kësaj pajisje është : Kamion me vinç me dy dyer.

Andaj, duke pas parasysh kërkesën e aneksit 7 të DT-së, si dhe dëshminë e ofruar nga OE për plotësimin e kësaj kërkese, rezulton që pajisja nuk është ofruar sipas kërkesës së DT-së, dhe këtë fakt e pranon edhe OE mirëpo thirret në atë se AK është dashur të kërkoj sqarime dhe ne do ta bindim AK-në, lidhur me këtë arsyetim eksperti shqyrtues sqaron se dispozita e nenit 72 të LPP-së,nuk ka karakter Obligativ per AK por thot qe mund te kerkoj sqarimi andaj vendimi i AK-së per të mos kërkuar sqarime eshte përgjegjsi e vetë AK-së.

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar për faktin se dëshmit e ofruar (Libreza) për pajisjen Kamion kiper me kran me peshë bartëse min 11 ton nuk është ofruar konform kërkesës së Dosjes së Tenderit.

OE ankues pretendon se:

Arsyeja e tretë - Lidhur me kërkesën që OE duhet të kenë kontratë me KMDK-në për hedhjen e mbeturinave që dalin nga realizimi i këtij projekti, ne kemi paraqitur një kontratë me KRM "Pastrimi" e cila sipas kësaj kontrate do të instaloj kontejner me volum 7.1m³ për hedhjen e mbeturinave të tilla që dalin gjatë realizimit të punimeve në këtë projekt. Këtë e kemi bërë me të vetmin qëllim që puna të realizohet më shpejt dhe që ne të mos kemi nevojë për dërgimin e mbeturinave të tilla deri tek deponia e KMDK-së por ato do të hidhen direkt në kontejnerët e tillë që mandej KRM Pastrimi do i zbrazte duke i dërguar në deponinë e KMDK-së sipas kontratës që ata e posedojnë për këtë qëllim. Kjo është plotësisht ligjore sidomos duke u mbështetur në nenin 69.8 të LPP-së i cili qartë e thotë se:

Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që

ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, ...

Pra bazuar në këtë dhe bazuar në raportet që KRM Pastrimi ka me KMDK-në, kontrata në fjalë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit që ishte vendosur vetëm për qëllimin e sigurimit që mbeturinat do të hedhen në deponitë adekuate e jo nëpër deponi të egra apo në vende të ndryshme publike e private me çka edhe do të ndotej ambienti. Kjo ofron siguri edhe më të lartë për atë qëllim dhe realisht si marrëveshje është edhe më e favorshme sidomos për menaxhimin e mbeturinave të tilla sepse mënyra e tillë është shumë më efikase se sa të dërgonim ne vet mbeturinat tek depo e KMDK-së pasi që kështu bëhet dhe ruajtja e pastërtisë së rrugëve të cilat zakonisht i ndotin kamionët që dalin nga vend punishtet për largim të mbeturinave.

Përgjigjje për arsyen e tretë

Eksperti Shqyrtues konstaton që kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*OE duhet të ketë kontratë me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (kërkohet për dy llot)* ". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Kontrata e nënshkruar dhe vulosur në mes KMDK dhe OE (valide)*".

Për plotësimin e kësaj kërkese të DT-së, OE ankues ka ofruar një marrëveshje (kontratë) me kompaninë

KRM "PASTRIMI" sh.a.

Duke pas parasysh kërkesën e DT-së dhe dëshmin e ofruar nga OE ankues për këtë pikë, rezulton se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën e DT-së, për faktin se kërkesa thuhet që OE duhet të ketë kontratë me KMDK dhe jo me ndonjë kompani tjetër. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

OE ankues pretendon se:

Arsyeja e katërt – Bazuar në vendimet e dorëzuara nga ne për caktimin e menaxherit të kontratës dhe udhëheqësin e punishtes shihet se ato i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për tu cilësuar si të rregullta. Fillimisht munden të trajtohen sipas nenit 59.4 të LPP-së ku gabimi në datën e vendimit konsiderohet plotësisht gabim teknik i cili nuk ndikon aspak në devijimin substancial të tenderit tonë. Pavarësisht kësaj dhe duke u bazuar edhe në dispozitën ligjore e cila e thotë qartë se të gjitha kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale të OE duhet të i paraprijnë situatës para

datës së njoftimit për kontratë, ku çdo dokument i dorëzuar duhet të posedoj datën e para hapjes publike duke **mos e kufizuar askund sa gjatë para hapjes publike**, vendimet e tilla duhet konsideruar ligjërisht si të pranueshme. Pra nuk ka asnjë dispozitë ligjore që ndodhet në legjislacionin primar e as sekondar të prokurimit që i jep të drejtë AK-së për të i cilësuar vendimet e tilla si jo të rregullta apo të pa pranueshme. Ligji dhe kërkesa e AK-së e kërkon që të jetë vendimi dhe të mos jetë i futur në dosje pas hapes publike, përndryshe nëse data është para hapjes publike apo edhe nëse i mungon fare, vendimin e tillë nuk e zhvleftëson ky fakt sidomos kur e ka emrin e projektit dhe numrin e projektit që sipas të gjitha dispozitave ligjore por edhe kërkesës së dosjes së tenderit konsiderohet i pranueshëm. Nisur nga kjo konstatojmë se vendimet e tilla janë plotësisht të pranueshme dhe arsyetimi i tillë i AK për refuzimin e tyre është tërësisht i pa-bazuar.

Referuar përgjigjes së AK-së të dhënë gjatë refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, shihet se të gjitha arsyetimet janë të pa argumentuara në aspektin ligjorë që të len përshtypjen se janë vetëm tentim për prolongim të pakuptimët të procesit. Asnjë nga arsyetimet nuk është e bazuar ligjërisht e as e mbështetur me ndonjë faktim por të gjitha janë hamendësime dhe thirrje në konstatime arbitrare.

Pas gjithë këtyre që i sqaruam më lartë, shihet se AK së bashku me Komisionin e Vlerësimit nuk kanë vlerësuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe nuk kanë vlerësuar as sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe kjo tregon se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

Përgjigjje në arsyen e katërt

Eksperti Shqyrtues konstaton që kërkesë e DT-së dhe Njoftimit për kontratë është kërkuar: "*Një) Menaxher i projektit - Inxhinier i diplomuar ose master i Hidroteknikës, minimumi 10 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1 (një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania".*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar*: "OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës (për pikat c (llot I dhe II) dhe f (llot I) edhe të certifikatave) të noterizuar nga origjinali (noterizimi mos të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë).*

Kontrata ose marrëveshja për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin , nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt atëherë duhet të jetë e noterizuar nga origjinali. Vendimi me

shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësit të jetë vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët dhe i noterizuar .

Ne lidhje me plotesimin e kërkesës së DT-së, OE ankues në ofertën e tij ka ngarkuar dokumentin Vendim për Menaxher, ku ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e ndërtimtarisë djetimi Hidroteknik, ky dokument përmban emërtimin e aktivitetit të prokurimit dhe numrin e prokurimit për të cilin është caktuar menaxheri i projektit, po ashtu eshte theksuar data 13.02.2022 si date e caktimit te menaxherit te projektit. Noterizimi i dokumentit eshte bere me dt. 13.06.2023.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne daten 13.02.2022 si date e caktimit te inxhinierit, mund te pranohet arsyetimi i OE si gabim teknik per faktin se ne daten te cilen ka vendosur OE nuk ka qene i publikuar njoftimi per kontrate dhe ne ate kohe OE ankues nuk ka mundur te dij as emertimin e aktivitetit te prokurimit as numrin e prokurimit, Andaj konsideroj si pjesërisht te bazuar pretendimin ankimor per arsyet e lartcekura dhe AK ka mundur të veproj konform nenit 72 te LPP-se, mirëpo megjithatë është në diskrecion të vetë AK-së që ta veproj sipas nenit 72 të LPP-së.

Pretendimi ankimor 4

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së si pasoj e mos respektimit të nenit 59 të LPP-së dhe si pasojë vlerësimin jo të drejtë të tenderëve konkurrues ku për pasojë të kësaj ka ardhur deri tek një aplikim i gabuar i nenit 62 të LPP-së dhe anulim i gabuar procedurës së prokurimit. Anulimi i tenderit edhe pse në mesin e tenderuesve e ka një tenderues të përgjegjshëm konsiderohet shkelje e parimeve të mira të prokurimit publik dhe konsiderohet aplikim komplet i gabuar i nenit 62 të LPP-së. Në rastin e tillë si pasojë e anulimit të pabazuar të tenderit po prolongohet projekti duke shkaktuar vonesa dhe shpenzime të panevojshme operative që është tregues real i mos shfrytëzimit të buxhetit në mënyrë efikase dhe efektive nga ana e AK-së

Nga krejt kjo po shihet hapur se veprimi i AK-së për anulim të tenderit përbën shkelje të plotë të nenit 62 të LPP-së.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 4

Eksperti Shqyrtues, sqaron se kjo procedurë e prokurimit është rivlersuar pas Vendimit të P.SH nr.531/23, Autoriteti Kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendereve

konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe ka rezultuar që nuk ka oferta të përgjegjshme dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit.

Eksperti Shqyrtues, vlerson se AK ka respektuar Nenin 62 të LPP-së, pasi që asnjë ofertë e pranuar për këtë AP nuk është e përgjegjshme.

Pretendimi ankimor 5

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe kërkesat që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mos respektimi i dëshmive tona kualifikuese, mos respektimi i dëshmive për stafin profesional dhe mos respektimi i dëshmive për pajisjet e paraqitura janë tregues të mjaftueshëm për të konstatuar se AK ka shkelur plotësisht nenin 69 të LPP-së. Këtë e vëreni nëse i shihni me kujdes dëshmitë tona të paraqitura në tenderin tonë të cilat tregojnë të kundërtën e asaj që e thotë AK në njoftimin mbi eliminim e tenderit tonë.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 5

Lidhur me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se arsyetimi i OE ankues se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së, nuk është i qëndrueshëm për faktin se AK ka vendosur kërkesat që duhet t'i plotësojnë OE për këtë AP, dhe mbi bazën e këtyre kërkesave OE do të duhej të ofertojnë, nëse eventualisht mund të ketë patur ndonjë vërejtje, sugjerim etj, ndaj kërkesave të DT-së, OE do të duhej të shfrytëzojnë të drejtën e tyre në afatin ligjor të paraparë. Andaj, Autoriteti kontraktues dotëkonsiderojënjëtendersi tëpërgjegjshëmvetëmnësetenderinë fjalëështë nëpërputhshmërimetëgjithakërkesateparashtruaranë njoftimine kontratësdhenë dosjenetenderit.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit të ri-vlerësimit sepse nuk ka kërkuar fare sqarime për disa paqartësi që shihet se i ka pasur tek tenderi jonë por pavarësisht kësaj ka vepruar në mënyrë arbitrare pa u siguruar me gjendjen reale duke na eliminuar për mangësi që do duhej sqaruar detyrimisht. Detyrimi i AK-së tregohet shumë qartë tek neni 72 i LPP-së si dhe tek neni 38 të RRPP-001/2022 ku përshkruhet detalisht se si duhet vepruar për të sqaruar mangësitë, dhe paqartësitë në tenderët

konkurrues. Në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon neni 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra bazuar në këtë që e thotë ky nen, shihet hapur se AK është dashur të kërkoj sqarime për të gjitha paqartësitë që i ka pasur rreth dëshmive tona ku pa asnjë të drejtë të njëjtat i ka cilësuar si të pa pranueshme duke na eliminuar dhe duke e shkelur plotësisht nenin 72 të LPP-së.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 6

Lidhur me pretendimin ankimor te siper theksuar, Eksperti Shqyrtues, sqaron se neni 72 i LPP-së mund te përdoret nga AK në, dhe në rastin konkret AK nuk ka kërkuar sqarime dhe mendoj se është në diskrecion të AK-së që të kërkojë sqarime apo jo sipas Nenit 72 të LPP-së.

Përfundim,

Pas analizimit te aktivitetit te prokurimit me titull "*Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike*" dhe nr. te prokurimit "*615-23-4020-5-1-1*", Eksperti Shqyrtues, vlerson se pretendimet ankimore ne lidhje me arsyet e eliminimit si pika e "*Lead Auditor*", "*Kamion kiper me kran me peshë bartëse min 11 ton*", "*mungesa e kontrates me KMDK*", janë

pretendime të pa bazuar, ndërsa arsyeja e eliminimit si pika per "*pajisjen per shpime horizontale*" eshte pike e bazua dhe pika "*vendimit te menaxherit"* eshte pjesrisht e bazuar.

Andaj, ne tërsi eksperti shqyrtues e vlerson si pjesrisht të bazuar ankesen e OE ankues dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, për faktin se me 3 arsyet e eliminimit te cilat u cilsuan si të pa bazuar, operatori ekonomik ankues është i pa përgjegjshëm për këtë AP.

Andaj, mbeshtetur ne Nenit 43.5 pika b e Rregullores per Prokurim Publik, rekomandoj te anulohet AP pasi qe asnjera nga ofertat nuk eshte e pergjgegjshme.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjeserisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica